

Shqipja standarde përballë veçorive dialektore ne mediat audiovizive ne Kosovë

*Manjola Lubishtani**

Përmbledhje

Mediat, si mjete bashkëkohore të shprehjes dhe komunikimit kulturor e gjuhësor, përbëjnë një nga hapësirat e detyrueshme ku shqipja standarde duhet të zotërohet e të promovohet.

Me njësimin e shqipes në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972, e paraprakisht me Konsultën e Prishtinës më 1968, standardi i shqipes u përqafua e u mbështet si variant zyrtar i përdorshëm në të gjitha sferat publike institucionale e arsimore edhe në Kosovë. Realiteti i sotëm dëshmon për një nivel zotërimi e përdorimi të pakënaqshëm të standardit kundrejt trajtave dialektore ose të folmeve krahinore, veçoritë e të cilave i hasim dendur në domenin mediatik.

Ky punim synon të sjellë një pasqyrë të gjendjes reale të përdorimit të standardit nga folësit e prezantuesit në disa nga transmetuesit elektronikë, si: RTK, Klan Kosova, RTV 21 e RrokumTv (ky i fundit si transmetues që promovon gegërishten, si variant gjuhësor ndaj standardit).

Do të përpiqemi të sjellim përgjigje për shkallën e përdorimit të standardit, ndikimin e formimit gjuhësor të të ftuarve ndaj prezantuesve, nivelin e zotërimit të standardit nga folësit e prezantuesit, përkushtimin e tyre për ta përdorur korrektësisht normën e shqipes standarde dhe tipologjinë e emisioneve, si diktuese të përdorimit të standardit dhe të trajtave dialektore.

Fjalë kyç: *gjuhë standarde, media, dialekt, veçori fonetike, të folme.*

Hyrje

Gjuha standarde ka hyrë tashmë në dekadën e pestë të kodifikimit e të funksionimit të saj si gjuhë e prestigjit në të gjitha sferat publike, ku

* MSc, Kolegji AAB, departamenti Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve, e-mail: manjola.lubishtani@aab-edu.net

mediat zënë një vend të rëndësishëm për përdorimin dhe kultivimin e këtij varieteti.

Megjithë periudhën e gjatë të standardizimit të gjuhës shqipe, zbatimi i saj në praktikë nuk është i kënaqshëm. Hapësira mediatike, padyshim, karakterizohet nga bashkëveprimi ndërnjerëzor, i cili realizohet me anë të gjuhës në të dy format ekzistenciale të saj: gjuhë e folur dhe gjuhë e shkruar. Në këtë marrëdhënie të pashkëputshme e ciklike, gjuha e medias shfaqet e pranishme me një përdorim shumëformësh, duke bërë që çdo ditë të ballafaqohemi me varietete të ndryshme gjuhësore, të cilat pohojnë moskonsolidimin e normës së shqipes në domenin mediatik. Formimi gjuhësor i drejtuesve të emisioneve, përkushtimi i tyre për të përdorur korrektësisht e me përgjgjësi shqipen standarde, faktorët e ndryshëm shoqërorë, si: situata, domeni, vendndodhja dhe tema e bisedës,¹ janë disa nga komponentët nxitës të përzgjedhjes së varieteteve gjuhësore në mediat audiovizive. Si pasojë, në komunimin ballë për ballë shumë shpesh shfaqet dukuria e zhvendosjes së stilit nga ana formale, drejt asaj më pak formale e joformale dhe anasjelltas.²

Në këtë punim do të pasqyrojmë, me anë të shembujve që janë klasifikuar nga një hulumtim sistematik një mujor, situatën reale të përdorimit të shqipes, duke u përqendruar në rastet e shpeshta të shkeljes së normës (veçanërisht në rrafshin fonetik e morfologjik), të cilat manifestojnë jo vetëm variacione shqiptimore dialektore, por edhe tipare të të folmeve rajonale e individuale, duke e rrezikuar seriozisht statusin e shqipes së normuar në ambientet televizive.

Rruga e formimit të gjuhës standarde shqipe dhe ndikimi në Kosovë

Rruga për të shtruar trasenë e një gjuhe të përbashkët mbi dallimet dialektore ndërmjet folësve të shqipes në mbarë trevat shqiptare,

¹ Shkumbin Munishi, *Përdorimi i shqipes në mediet audio-vizuale: çështje të përzgjedhjes së kodit*, Filologji 20, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2013, f.157.

² Po aty.

karakterizohet nga përpjekje të shumta të rilindësve, të cilët, nën ndikimin e mjaft faktorëve të ndryshëm historikë, politikë, shoqërorë e kulturorë, me qëllimin e vetëm për t'i shërbyer bashkimit kombëtar, historikisht kanë kontribuar në krijimin e një sërë alfabetesh, numri i të cilëve, në prag të Kongresit të Manastirit (1908), erdhi duke u pakësuar për t'u përqendruar në tri alfabetet më të përdorura: alfabeti i *Stambollit* (1879), alfabeti i *shoqërisë "Bashkimi"* (1899) dhe alfabeti i *shoqërisë "Agimi"* (1901).³ Kongresi i Manastirit i finalizoi këto përpjekje duke krijuar një alfabet, i cili është alfabeti që përdorim edhe sot.⁴ Krijimi i këtij alfabeti do të ndiqet kronologjikisht nga disa ngjarje të rëndësishme, vendimtare për procesin e konsolidimit të standardizimit të shqipes, siç janë: *Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës* (1916-17), *Konsulta Gjuhësore e Prishtinës* (1968) dhe *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe* (1972).

Kështu, Komisia Letrare e Shkodrës me synimin e krijimit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe vendosi që ortografia e shqipes të mbështetej në të folmen e Elbasanit. *Argumentet pro elbasanishtes më shumë ishin të natyrës integruese dhe gjeografike, meqë kjo zonë ndodhet më afër të dyja dialekteve kryesore, edhe pse në bazën e saj ishte gegërishte jugore.*⁵ I njohur nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920) dhe i dekretuar si gjuhë zyrtare e Shqipërisë (1923), ky variant do të marrë përfundimisht vulën e gjuhës së standardizuar, duke bërë që në vitet e 20-ta e të 30-ta të shek.XX të konsiderohet si bazë themelore e drejtshkrimit të variantit letrar të gegërishtes.⁶ Lidhur me këtë, Sindorela Doli-Kryeziu⁷ pohon se "ky variant letrar është përdorur pas Luftës II Botërore edhe në Kosovë dhe Maqedoni si normë e vetme e folur dhe e shkruar e gjuhës letrare shqipe, gjer në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), por gjithashtu, ka pasur një bazë pak më të

³ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, AShSh, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2004, f. 281.

⁴ Po ai. f.282.

⁵ Rrahman Paçarizi, *Gjuha shqipe*, Thesis Kosova, nr.1, AAB, Prishtinë, 2008, f. 106.

⁶ Fadil Raka, *Historia e shqipes letrare*, Prishtinë, 2005, f. 195-196.

⁷ Sindorela Doli-Kryeziu, *Shtirirja e shqipes standarde në Gjakovë*, Disertacion doktorate, Tiranë, 2013, f. 34.

gjerë dhe përfshinte elemente gjuhësore edhe të të folmeve të tjera të gegërishtes.” Praninë e gegërishtes letrare e pohon edhe Desnickaja⁸ kur shkruan se “...në Kosovë, për shkak të ndikimit reciprok në mes gjuhës letrare dhe dialektore nuk merr pjesë trajta e jugut e gjuhës letrare shqipe, por në të gjitha trajtat e të folmes së shkruar dhe gojore-publike përdoret vetëm norma gege e gjuhës letrare.”

Janë intelektualët shqiptarë të Kosovës⁹, ata të cilët në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës (1968) vendosën “të merrnin qëndrim për fatin e shqipes letrare në Kosovë dhe në vise të tjera ku jetonin shqiptarët etnikë në ish-Jugosllavi, dhe të diskutonin Rregullat e drejtshkrimit (projekt) të 1967-s.”¹⁰ Me moton *Një komb- një gjuhë letrare- një drejtshkrim* Konsulta e Prishtinës jetësoi pranimin njëzëri “si gjuhë të vetën letrare gjuhën letrare të vendit ëmë”.¹¹ Bazuar në vendimin e marrë “si një hap të rëndësishëm të unifikimit të gjuhës letrare” në të gjitha institucionet e entet arsimore - pedagogjike, gazetareske e botuese, shkencore e kulturore u kërkua në formë imperative zbatimi sa më i shpejtë i tij.¹²

Shqipja standarde dhe realiteti gjuhësor në Kosovë

Sot, 43 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit, shqipja standarde gjendet në mes të një realiteti dualist me jo pak probleme në rrafshin e përvetësimit e të zotërimit të saj si gjuhë me prestigj, duke u ndeshur me një ambient gjuhësor, në të cilin gjuha e folur dukshëm dallon nga ajo e shkruar. Ky zhvillim i ndarë dhe paralel, çdo ditë e më shumë, po e thëllon hendekun e krijuar ndërmjet standardit dhe varieteteve gjuhësore, duke krijuar jo rrallë edhe ndjenjë inferoriteti ndërmjet vetë

⁸ Agnia Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, Prishtinë, 1972, f. 124.

⁹ Konsulta e Prishtinës u organizua nga Instituti Albanologjik dhe Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe e Fakultetit Filozofik të Prishtinës, më 27-28 prill 1968.

¹⁰ Fadil Raka, vep. e cit., f. 227.

¹¹ Rami Memushaj, “46 vjet nga Konsulta e Prishtinës-lufta për njësimin e gjuhës”, Shqiptarja.com, 22 prill 2014.

¹² Po aty.

folësve. Këtë realitet, pohon sociologu Besnik Pula¹³, nuk mund ta mohojnë as linguistët kosovarë, të cilët jetojnë në universin e strukturuar dhe logjik të gjuhës letrare vetëm në tekst dhe në konstruksione letrare, por jashtë kësaj bote të imagjinuar nuk ndjehen të ngushtuar që në gjuhën letrare të komunikojnë me nënën, vëllanë ose kushëririn. Në Kosovë, gjuha letrare, si gjuhë e dokumenteve administrative, e gazetarisë dhe e letërsisë, e politikanëve dhe e njerëzve të dijes, luan rolin e një gjuhe të kumtit apo të shpalljes, e një gjuhe të autoritetit (politik, moral, shkencor).

Në një intervistë të saj, albanologia Shefkije Islamaj¹⁴ radhit si faktorë që përcaktojnë sot zhvillimin e shqipes standarde dhe, rrjedhimisht, edhe problemet që shfaqen në këtë rrafsh, cilësinë e shkollës shqipe, sidomos në Kosovë, duke përfshirë këtu procesin e mësimdhënies, përgatitjen e kuadrove, cilësinë e teksteve mësimore; statusin e shqipes në hapësirën shqiptare brenda dhe jashtë kufijve, në trojet shqiptare e në diasporë; përpjekjen për copëzimin e hapësirës gjuhësore a variantizimin e saj; përpjekjet për ndryshimin e standardit; globalizimin; zotërimin e mangët të normës gjuhësore; shkallën e ulët të kulturës gjuhësore; imponimin e gjuhës së mediave dhe të gjuhës bisedore si stile kryesore funksionale; rënien e disiplinës dhe të përgjegjësisë në institucionet arsimore, institucionet publike dhe në media; vulgarizimin e gjuhës së mediave, teatrove, filmit, letërsisë, si edhe të gjuhës së përditshme; depërtimin e madh të fjalëve të huaja, sidomos të anglicizmave në shqipen; zvogëlimin e kuadrit, mungesën e një ligji për përdorimin e gjuhës standarde në institucionet publike etj. Ndërsa Rahman Paçarizi¹⁵, tekta flet për shkaqet e mospërhapjes së kënaqshme të standardit të folur të shqipes së normuar nga folësit nativë, veçanërisht ata gegë në Kosovë,

¹³ Besnik Pula, *Gjuha letrare dhe sfera publike në Kosovë*, 24 janar 2003, në eëë. vetevendosje.org.; qasja për herë të fundit më 10 maj 2015.

¹⁴ Shefkije Islamaj, *Kush shkruan për shqipen standarde si për një projekt të dështuar, nuk është serioz:shqipja standarde apo modernizim*, Sot Neës, 5 dhjetor, 2010, f.22; qasja për herë të fundit më 10 maj 2015.

¹⁵ Rahman Paçarizi, *Rruga e zhvillimit të shqipes standarde në raport me nevojat e komunikimit*, QSA, Tiranë, 2011, f.97, (cituar këtu sipas: Haki Hysenaj, *Shqipja e folur 40 vjet pas standardizimit të gjuhës*, Tiranë, 2012).

saktëson se shqipja e folur në Kosovë dallonte nga ajo në Shqipëri për faktin se e folura standarde në Shqipëri për bazë kishte marrë "modelin vokal të toskërishtes", ndërsa e folura standarde në Kosovë u mbështet mbi të folurën e vernakularit të Prishtinës, i cili ndonjëherë kishte edhe karakteristika të stërkequra të modelit vokal të Kosovës. Ai¹⁶ e sheh shtrirjen e gjuhës standarde të përqendruar kryesisht në shkollë, në një pjesë të letërsisë dhe në medie, duke e cilësuar pranimin e saj nga qarqet intelektuale në Kosovë si nevojë identitare e jo si një proces të natyrshëm standardizimi¹⁷, i cili do të garantonte funksionalitetin dhe pranueshmërinë e gjerë në domenet përkatëse të përdorimit.

Norma e shqipes përballë dialekteve në hapësirën mediatike

Edhe pse debatet, kryesisht rreth bazës dialektore të shqipes, vazhdojnë të jenë të pranishme në sferat akademike e më gjerë, shqipja standarde gëzon statusin e gjuhës zyrtare dhe, si e tillë, deri në reformimin e pasurimin e saj, duhet të respektohet e të përdoret korrektësisht. Nga gjithë ajo çka parashtruar më lart, nuk ka dyshim se mediat, si mjete bashkëkohore të shprehjes dhe komunikimit kulturor e gjuhësor, përbëjnë një nga hapësirat e detyrueshme ku shqipja standarde duhet të zotërohet e të promovohet. Realiteti i sotëm dëshmon për një nivel zotërimi e përdorimi të pakënaqshëm të standardit kundrejt trajtave dialektore ose të folmeve krahinore, veçori të cilat i hasim dendur në domenin mediatik.

Gjuha është mjeti kryesor i komunikimit ndërmjet njerëzve. Ajo, me të dy format e saj, të folurin dhe të shkruarin, realizon komunikimin jo vetëm ballë për ballë, po edhe në situata kur palët e përfshira nuk zhvillojnë komunikim të tillë. Media, sipas tezës së

¹⁶ Rrahman Paçarizi, *Gjuha shqipe*, Thesis Kosova, nr.1, AAB, Prishtinë, 2008, f. 108.

¹⁷ Për më shumë, lidhur me etapat që duhet të kalojë një variant për t'u standardizuar, shih: Richard A. Hudson, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2001, f. 43.

Mekluhanit, në fakt nuk është asgjë tjetër, pos mesazh.¹⁸ Televizioni, si një nga mjetet audiovizive të përhapjes së informacionit, mundëson këtë akt komunikimi duke vënë përballë njëri-tjetrit dërguesin e mesazhit dhe pranuesin e tij. Zhvillimi i televizioneve, që shoqërohet edhe nga synimi për rritjen e audiencës, dikton edhe një ndikim më të madh në kulturën gjuhësore të publikut. Por, nëse në gazeta e revista trajtat e shkruara gjuhësore shfaqen pothuajse të konsoliduara, me gabime minore në përdorimin e gjuhës standarde, situata në median audiovizive lë për të dëshiruar. Kjo është edhe arsyeja e zhvillimit të këtij hulumtimi, me anë të të cilit do të shpalosim një pasqyrë të gjendjes reale të përdorimit të standardit nga folësit e prezantuesit në disa nga transmetuesit elektronikë, si: RTK, Klan Kosova, RTV 21 e RrokumTv (ky i fundit si transmetues që promovon gegërishten, si variant gjuhësor ndaj standardit).

Raporti i përdorimit të gjuhës standarde ndaj të folurit të zakonshëm të individit varet në radhë të parë nga tipologjia e emisionit dhe nga qëllimi e objektivat në raport me publikun. Kështu, në edicionet informative, që kryesisht karakterizohen nga komunikimi njëkahësh i folësit televiziv, dominon përdorimi i formave standarde të shqipes, por pjesërisht të shoqëruara nga variacione individuale shqiptimore që lidhen kryesisht me zanoret hundore dhe me rrafshimin e kundërvënies ndërmjet qiellzoreve *q-gj* dhe afrikateve *ç-xh*.

Krejt ndryshe paraqitet situata formale gjuhësore në debatet televizive apo dhe në emisione të karakterit social ose argëtues, audienca e të cilave mishëron strukturë shumë më të gjerë e më të larmishme. Si pasojë edhe ndikimi i modelit gjuhësor është më i fuqishëm. Meqenëse në debatet televizive komunikimi zhvillohet në formë interaktive ndërmjet pjesëmarrësve, fillimisht vihet re një kujdes i shtuar, shpesh edhe i sforcuar, për përdorim e respektim të normës standarde nga ana e drejtuesve të emisioneve. Kjo edhe në sajë të presionit psikologjik, i cili krijohet nga prania e kamerave, mikrofonave dhe faktit që gjenden nën gjykimin e publikut. Por, nëse

¹⁸ Ibrahim Berisha, *Media - agjensët e komunikimeve*, Pen - AAB; Botimi 3, Prishtinë, 2009, f. 46.

te drejtuesit (folësit, prezantuesit, gazetarët etj.) kjo situatë duhet të shoqërohet nga rritja e përgjegjësisë, te shumica e bashkëbiseduesve ajo krijon efekt të kundërt, pasi trysnia e tillë prodhon edhe zhvendosje të stilit të të folurit, i cili shoqërohet edhe nga ndryshimi i ritmit të bisedës, kryesisht përshpejtim i tij, ngaqë folësit ndihen shumë më komodë kur shpërfaqin tipare të të folurit të tyre të zakonshëm.

Situata të tilla hasen dukshën në ekranet tona dhe shembujt e mëposhtëm e dëshmojnë këtë:

1. Debatit¹⁹ është realizuar me pjesëmarrjen e drejtuesit, të analistëve dhe dy të ftuarve. Ky emision është karakterizuar nga zhvendosje të stilit të të folurit dhe dominim të elementeve dialektore nga pjesëmarrësit. P.sh.: *"Greva e punëtorëve të arsimit është duke vazhduar edhe sot e tashmë është e konfirmuar që do të ketë përparime në negociatat me ministrinë..."*, *"...kemi mësimdhënës që thjesht shkojnë në punë vetëm për ta marrë pagën...kundrejt trajtave dialektore"...nuk pati gadishmëni për me qenë në studio"*; *"...kemi një situatë të krijume..."*; *"Tash po du me theksu..."*; *"Dhe në fund ka ardhë..."* etj.

2. Edhe në këtë emision²⁰ vihet re një prani e dukshme e variacionit dialektor nga të dy pjesëmarrësit, kryesisht në përdorimin e formave të pashtjelluara foljore: *"Ai ka gati dy muaj e gjysmë..... që është larguar nga..."*, *"...për të filluar me prologun e kapitullit të parë..."* kundrejt trajtave dialektore *"me çka e keni nisë këtë rrëfim?"*; *"Kjo propagandë, fatkeqsisht, asht propagandu nga shumë intelektualë..."* etj.

3. Drejtuesja e këtij debati²¹ manifeston përdorim korrekt të normës së shqipes. Shmangiet nga kjo normë hasen gjatë ecurisë së debatit i cili, kur tensionohet, dominohet nga zhvendosja e theksuar e stilit të bashkëbiseduesve, nga ai i kontrolluar në atë impulsiv me plot veçori individuale dialektore, karakteristike për një varietet të ulët, e që shfaqen nga përdorimi i gabuar i formave të pashtjelluara foljore dhe i përemrave vetorë e pronorë; nga prania e dukurive fonetike që lidhen me modifikimet ose ndërrimet e fonemave, si dhe me praninë e zanoreve hundore, etj. P.sh.: *"Edhe po du me u ndërlihd (!) te plani*

¹⁹ Click, *Greva në arsim- arsyet dhe pasojat.*, RTV 21, 30. 04. 2015.

²⁰ "Zona e debatit", Klan Kosova, 30. 04. 2015.

²¹ "Ju flet Prishtina", Klan Kosova, 03. 05. 2015 (Ritransmetim).

rregullativ...”, “..keni ngritë çështje...”, “...nuk je tu m’lon me përfundu...”; “Une po ju them: ma s’mirti e dëshmon kjo...”, “..veç te përfundoj edhe qeto...”, “...propozimet e tyne.” etj. Në kuadër të të njëjtit emision, gjatë intervistës së realizuar me një nga këshilltarët e Kuvendit Komunal kemi konstatuar një varg shkeljesh të normës së shqipes nga gazetarja intervistuese, si p.sh.: përdorim i gabuar i parafjalës dhe i emrit në rasën rrjedhore “...menjëherë mas luften..” në vend të “..menjëherë pas luftës..”, “Ecjen ne e kemi vazhdu te sheshi ‘Ibrahim Rugova’ në vend të “Ecjen ne e kemi vazhduar te sheshi ‘Ibrahim Rugova’”, “Me çfarë projekti jeni ndi krenar?” në vend të “Me çfarë projekti jeni ndier krenar” ...

Raportet gjuhë e shkruar dhe gjuhë e folur dukshëm janë thelluar edhe në emisionet që trajtojnë tema sociale, mjaft të afërta me përditshmërinë e audiencës, si dhe ato të karakterit argëtues, të cilat kanë një ndikim shumë të fuqishëm te moshat e reja. Janë shqetësuese rastet e shpeshta të shkeljes së normës (veçanërisht në rrafshin fonetik e morfologjik), të cilat manifestojnë jo vetëm variacione shqiptimore dialektore, por edhe tipare të të folmeve rajonale e individuale, duke e rrezikuar seriozisht statusin e shqipes së normuar në ambientet televizive. Më poshtë, po renditim disa shembuj nga ligjërimi i prezantuesve dhe i gazetarëve në studio, të cilët pasqyrojnë gjendjen reale të (mos) përdorimit të varietetit normativ:

Unë shpresoj që kur të rritesh të na e ndritësh ftyrën. ...Ma murr mendja.... Jemi kthyer në studio... Prindërit i bijnë fëmijët në vizita para se me u mirr me sport? ... i shohim fëmijët me veshje sportive, të cilat duken të holla me i pa me sy. Edhe prindërit janë ata të cillt për fëmijun e tyre kërkojnë.... Sporti është mënyra më e mirë që fëmiju juaj të shtijë në lëvizje krejt trupin. Dashta ta pys edhe trajnerin. Qysh e keni prit ju dhe shoqnia? Nuk mundet edhe Gërmia me na nxan atje.²²

Emisionet argëtuese karakterizohen nga një “sjellje e lirë dhe mjaft e shpenguar gjuhësore” e drejtuesve, kryesisht në moshë të re, të cilët dëshmojnë një njohje të dobët të standardit. E folmja e tyre shfaq variacione dialektore rajonale e sociale, duke iu afruar shumë herë edhe thjeshtligjërimin, i cili del nga kufijtë e normës. Shkeljet

²² “Familja ime”, Klan Kosova, 03. 05. 2015.

pasqyrojnë përdorime trajtash gjuhësore që ngërthejnë sferën fonetike, si: asimilimin e tingujve, shtesat ose rëniet e tingujve, elizionin, theksin; sferën morfologjike, kryesisht përdorimet foljore, përshtatjet e mbiemrave me emrat përkatës, përdorimin e përemrave etj.:

I. " Shpresoj që **jeni da** të kënaqur me atë që kemi përgatitur.", "Javës tjetër **do të vie...**"²³

II. "Mos **pritoni**, aplikoni...", "Vetëm **jasht do t'i gjuni**.", "Garuesi, siç **pe shihni, është në litar**.", "Tërhiqe pak **ma shu:m!**", "Kjo **sfi:d** e përcakton edhe **fitusin** e kësaj gare.", "Sfidoje, **nxjerre hakun e fitores**", "...nëse e **rrxoni të dy:t.**", "Çfarë **gëzimi osh**t ky?!"²⁴

III. "**shpeshhere m'kan pyt.**", "Pse e **don publiku aq sh:um at' njëri?**", "Ato **t'cillat japen, japen për mos m'u përmend.**", "...**mos me t'u shterr zoni.**"²⁵

Shembujt e ofruar janë dëshmi e përdorimit të formave gjuhësore joformale gjatë ligjërimit të folur e spontan të prezantuesve televizivë, i cili karakterizohet nga mungesa e përgjegjësisë dhe e vëmendjes për të respektuar standardin, kundrejt rasteve kur materialet janë paraprkishtë të hartuara e, si rrjedhojë, lexohen pa vështirësi nga të njëjtët prezantues. Por, ajo që do të parashtrijmë më poshtë shënon rastet më flagrante që kemi konstatuar gjatë përpunimit të të dhënave në këtë hulumtim. Bëhet fjalë për dy emisione të karaktereve të ndryshme, i pari me karakter investigativ, dhe i dyti me karakter argëtues. Situatat e regjistruara gjuhësore shpërfaqin nivelin më të ulët të njohjes, zotërimit dhe përdorimit të normës së shqipës, e cila gëzon statusin e gjuhës së prestigjit. Në emisionin "*Drejtësia në Kosovë*"²⁶ shpalosen dy realitete gjuhësore: ai i folësit që përdor saktë trajtat e normuara, dhe në anën tjetër ai i gazetarit intervistues, i cili rrënon krejtësisht këto trajta, duke përdorur një varietet që është shumë larg prej dialektit, edhe pse supozohet që intervista duhet të jetë paraprkishtë e përgatitur. Pyetjet e drejtuara nga gazetari janë këto:

- *A mund t'na tregoni rreth punës juve?*

²³ "Refleks", RTK, 02 .05. 2015.

²⁴ "SuperSfida", Rtk. 03. 05. 2015.

²⁵ "Një kafe me Labin", RTV 21, 03. 05. 2015.

²⁶ "Drejtësia në Kosovë", RTK. 01. 05. 2015.

- Kur po **thu** mosmarrëveshje verbale, çka po nënkupton?
- Çfarë fjalësh **ka pas atë n'at** mbledhje?
- Çka i **ke thon** ti z. T..... kur **ai osht dash me thirrë** policinë?
- Presione prej **kujna**?
- Çka **ki me bo tash? Cilla osht rruga qi ki me ndjek**?
- A i **kini bo dert ju me dikon n'parti**?
- A keni **qa hall me dikon tjetër**?
- D.m.th ju **po thuni që n'vazhdimësi ka ndodh**?
- Nëse kjo gjendje vazhdon, çka do të ndodhë me Trepçën? Ku **jet nesër**?

Edhe më devijuese shfaqet situata gjuhësore në emisionin "Wazzup"²⁷, i cili shfaqet në ekran çdo pasdite duke ofruar komunikimin e drejtpërdrejtë me të rinjtë nëpërmjet shfrytëzimit të rrjeteve sociale. Si pasojë, edhe modeli gjuhësor që ofrohet, i etiketuar si "gjuha e të rinjve", nuk i përmbush aspak kriteret e përdorimit në domenin e caktuar mediatik.

Edhe në këtë emision, rubrikat e përgatitura lexohen në standard, por gjithsesi të dalluara nga një stil jo i natyrshëm, i karakterizuar nga variacione shqiptimore dialektore. Por, ajo që vihet re, me një tendencë shqetësuese, është fakti se drejtuesit e tij tregojnë një sjellje refuzuese, e ndonjëherë edhe përçmuese ndaj vetë normës, duke shfaqur zëvendësim të kodit të varietetit të lartë me atë të një varietetit më të ulët, p.sh.: "Kjo është një politikë e **mençur**.... e përsërit...një politikë e **mençme**.", "Ai tipi **ka pshtu**, mandej ia 'futi me të **katra**'."

Ja disa nga shembujt e shkëputur gjatë komunikimit të prezantuesve:

- Kjo e fundit **ke kapaku**- 82 vjeçare **m'u bo** modele.
- Krejt i **lexojna**. Edhe **un hi** e i lexoj. - Në disa media **shkrujke**....
- **Hala asgjo zyrtare** nuk ka... - **Mos kofsh** shqiptar **me kallxu** veten.- Ohoo, **t'lutna**..... rri. - **Faimnderit shu:m!** - **Për qata ta zgjedha**, se e di që **t'pëlqen**. - **Po get** edhe **njerzve** u pengon. - **S'koka** puna **mir**, hiç. -**Kangën e re** që **ja nxjerrëm** ne **fjalt**. - **Shu:m ke** e bukur, edhe **mu m'pëlqej**.

²⁷ "Wazzup", Klan Kosova, 15. 04. 2015.

E thamë edhe më lart se mediat përfaqësojnë një nga domenet ku gjuha e normuar standarde duhet të përdoret e të transmetohet korrektësisht te publiku i gjerë. Krahas konstatimit të formave me të cilat ajo paraqitet në disa prej mediave audiovizuale, në këtë punim i kemi kushtuar një hapësirë modeste edhe përdorimit të variantit dialektor në Rrokum Tv. Nisur nga politikat drejtuese, ky televizion, që në fillet e tij, ka propaganduar përdorimin e “variantit gegë” ndaj atij të normuar. Shembuj të tillë ndërtimesh, si “*Talenti i ri holandez Memphis Depay ka fillue me u krahasue me lojtar të medhaj të Manchester United'it hala pa fillue me luejt për këtë ekip*”; “*S'un e marrin veten Milwaukee Bucks*”; “*Femite e varfun i pergjigjen Ibrahimovic'it*”²⁸; “*Kur Madona knon me instrumente shkollore. Ngone!*”²⁹ hasen pothuajse çdo ditë në ekranin dhe në faqen zyrtare të këtij transmetuesi.

Por, a i shërben kjo zgjedhje gjuhësore audiencës? Mbi cilin variant të normuar gegë mbështeten redaktorët e tij? A i ka kaluar ky variant etapat e duhura, të cilat do t'i garantonin të qenët e një “gjuhe prestigji”, krahas standardit që tashmë ekziston?

Richard Hudson³⁰, teksa flet për raportet *gjuhë standard* dhe *dialekte*, thekson se “gjuhët standarde janë interesante, sepse vendosin një raport të posaçëm me shoqërinë.... Ato janë produkt i një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe të paramenduar nga ana e shoqërisë.” Po sipas tij³¹, për t'u certifikuar si e tillë, një gjuhë standarde duhet të kalojë këto etapa: 1) *Përzgjedhja* (seleksionimi i një varieteti ekzistues, ose përzierje varietetesh të ndryshme); 2) *Kodifikimi* (një institucion, p. sh., një akademi duhet të hartojë fjalorë dhe gramatika “për të fiksuar” format e sakta me pajtueshmërinë unanime të hartuesve. Këto forma duhet të përdoren korrektësisht nga qytetarët, pa përdorur format “e pasakta” që mund të ekzistojnë në varietetin e tyre të lindjes); 3) *Kultivimi i funksionit* (përdorim i tij në të gjitha sferat publike: qeveri, parlament, gjykata, arsim, dokumente zyrtare e shkencore, dhe pa dyshim në forma të ndryshme të

²⁸ Rrokum HD, faqja online, 13. 05. 2015.

²⁹ Po aty, 13. 04. 2015.

³⁰ Richard A. Hudson, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2001, f. 43.

³¹ Po ai, ff. 43-44.

letërsisë); 4) *Pranimi* nga popullsia si varietet *i vetëm* i bashkësisë, pra, normalisht, si gjuhë kombëtare. Vetëm kështu, gjuha standarde shërben si forcë e fuqishme *unifikuese* për shtetin, si simbol *i pavarësisë* së tij nga shtete të tjera (nëse gjuha e tij standarde është unike dhe jo e përbashkët me të tjerët) dhe si shenjë *e dallimit* përkundrejt shteteve të tjera.

Është e dukshme që zgjedhja dhe favorizimi i varietetit që përdoret nga ky transmetues nuk ka ndjekur këtë procedurë standarde, dhe përderisa kjo nuk ndodh, norma ekzistuese duhet të zërë vendin që meriton.

Përfundime

Rastet e mësipërme dëshmuar për një situatë ku variacionet dialektore dominojnë dukshëm ndaj normës së shqipes standarde, si rrjedhojë e së cilës varieteti i lartë nuk ka arritur të akomodohet natyrshëm e në mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe kjo jo nga mungesa e aftësisë për ta nxënë standardin, por nga mungesa e edukimit dhe e vetëdijësisë të gjeneratave të reja për domosdoshmërinë e njohjes dhe të zotërimit të tij në sferat e shumta jetësore. Shmangiet e shumta nga norma e shqipes diktojnë një nevojë emergjente të trajtimit me përgjegjësi e të respektimit të gjuhës standarde në domenin mediatik. Kjo lidhet jo vetëm me zbatimin ligjor në hapësirat televizive, por duhet të shoqërohet nga një edukim i mirëfilltë e rigoroz gjuhësor i çdokujt që dëshiron t'i përkushtohet gazetarisë e televizionit.

Atë çka nuk po arrin ta realizojë si duhet shkolla, si institucion themeltar i edukimit normativ gjuhësor, media duhet ta plotësojë me të gjitha mundësitë, sepse kjo nuk është asgjë më shumë sesa përmbushje e spektrit funksional të saj.³²

³² B. Musai, J. Godole, T. Abdurrahmani, *Edukimi mediatik*, Instituti Shqiptar i Mediave, Tiranë, 2011, f. 9.

Bibliografi

Berisha, Ibrahim. *Media - agjensët e komunikimeve*, Pen- AAB, Botimi 3, Prishtinë, 2009.

Desnickaja, Agnia. *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, Prishtinë, 1972

Dodi, Anastas. *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, AShSh, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2004.

Doli-Kryeziu, Sindorela. *Shtrirja e shqipes standarde në Gjakovë*, Disertacion doktorate, Tiranë, 2013.

Hudson, Richard A. *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2001.

Hysenaj, Haki. *Shqipja e folur 40 vjet pas standardizimit të gjuhës*, Tiranë, 2012.

Islamaj, Shefkije. *Kush shkruan për shqipen standarde si për një projekt të dështuar, nuk është serioz:shqipja standarde apo modernizim*, Sot Neës, 5 dhjetor, 2010; qasja për herë të fundit më 10 maj 2015.

Memushaj, Rami. "46 vjet nga Konsulta e Prishtinës-lufta për njësimin e gjuhës", Shqiptarja.com, 22 prill 2014.

Munishi, Shkumbin. *Përdorimi i shqipes në mediet audio-vizuale: çështje të përzgjedhjes së kodit*, Filologji 20, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2013.

Musai, B.; Godole, J.; Abdurrahmani, T. *Edukimi mediatik*, Instituti Shqiptar i Mediave, Tiranë, 2011.

Paçarizi, Rahman. *Rruga e zhvillimit të shqipes standarde në raport me nevojat e komunikimit*, QSA, Tiranë, 2011.

Paçarizi, Rahman. *Gjuha shqipe, "Thesis Kosova"*, nr.1, AAB, Prishtinë, 2008.

Pula, Besnik. *Gjuha letrare dhe sfera publike në Kosovë*, 24 janar 2003, në www.vetevendosje.org.; qasja për herë të fundit më 10 maj 2015.

Raka, Fadil. *Historia e shqipes letrare*, Grafikos, Prishtinë, 2005.